



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 203, Datë 10.08.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS NR. 373 SERIA T17 TË SHOQËRISË “PPC ALBANIA”
SH.A., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 93, DATË 04.07.2017**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37 pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, 5 pika 1, gërma “d”, nenit 10, pikat 4, 5 dhe 6, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenin 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1439 prot., datë 05.08.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a., me nr. 373 seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 108, datë 19.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 373 Seria T17, të shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/20 prot., datë 20.05.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 03.06.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 478/1 prot., datë 01.06.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Duke qenë se nuk u depozitua dokumentacion nga ana e shoqërisë dhe kërkesa e saj për shtyrjen e vendimmarrjes përfundimtare të bordit të ERE-s pa caktuar një afat për plotësimin e dokumentacionit me shkresën e protokolluar në ERE nr. 478/4 prot., datë 13.06.2022, bordi i ERE-s me vendimin nr. 160, datë 17.06.2022, vendosi të refuzojë kërkesën e shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a. për rinovimin e licencës nr. 373, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin nr. 93, datë 04.07.2017.
- Shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 478/8 prot., datë 14.07.2022, ka depozituar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Në nenin 10, pikat 5, 6 dhe 7, “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, pavarësisht se parashikohet e drejta e aplikuesit për paraqitjen e një aplikimi të ri brenda 30 ditëve nga vendimi për mosfillimin e procedurës, dhe bazohet te neni 6, i cili nga ana e tij ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për licencim, është e qartë se në këto rrethana kjo e drejtë i njihet aplikuesit dhe në rastet kur është marrë vendimi për refuzimin e kërkesës, pasi kushti thelbësor nuk është procedura në këtë rast, por afati, pra ka të bëjë me gadishmërinë e aplikuesit për t’iu përgjigjur udhëzimeve të dhëna nga ERE brenda 30 ditëve.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionine kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 373 Seria T17, të shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 05.07.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI